

SHTATOR 2024

FORCOJMË DREJTËSINË DHE PËRSHPËJTOJMË INTEGRIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN



Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, priti në takim Sekretarin e Shtetit të Suedisë, z. Mikael Kullberg, dhe delegacionin e Ministrisë së Drejtësisë së Suedisë. Gjatë takimit, u zhvilluan bisedime të frytshme mbi zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e drejtësisë, përfshire pëmirësimin e sistemit penitenciar dhe perspektivat në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ministri i Drejtësisë vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Suedisë për fuqizimin e institucioneve tona të drejtësisë dhe kontributin e çmuar në avancimin e reformave thelbësore, që përbëjnë një shyllë kyçë për zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe përafirmin e saj me standartet evropiane. Ky bashkëpunim i fortë dhe i qëndrueshëm me Suedinë dëshmon përkushtimin e përbashkët përtë forcuar shtetin e së drejtës dhe përtë avancuar në rrugën e integrimit evropian të vendit tonë.



HAP HISTORIK PËR DREJTËSINË SHQIPTARE, NËNSHKRUHET KONVENTA E HAGËS PËR NJOHJEN E VENDIMEVE GJYQËSORE SHQIPTARE NË SHTETET ANËTARE

Shqipëria ka nënshkrur Konventën e Hagës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në çështjet civile dhe tregtare, një hap i rëndësishëm që garanton njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore shqiptare në të gjitha shtetet anëtare. Kjo arritje riafirmon përkushtimin e Ministrit të Drejtësisë përtë ndërtuar një sistem drejtësie më të besueshëm dhe të aksesueshëm për qytetarët dhe bizneset shqiptare, duke ulur ndjeshëm kostot dhe kohën e ekzekutimit të vendimeve civile dhe tregtare, gjë që përmirëson ndjeshëm klimën e biznesit në Shqipëri. Konventa vendos një gurhemel të fortë në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përafrimin e legjislatacionit shqiptar me standartet e Bashkimit European. Si anëtare e Konferencës së Hagës përtë Drejtësin Ndërkombëtare Private, Shqipëria është tanë pale në 17 konventa të kësaj organizate, katër prej të cilave janë firmosur nën drejtimin e Ministrit të Drejtësisë Ulsi Manja, duke forcuar reputacionin e Shqipërisë në drejtësinë ndërkombëtare.



"KAPITULL I RI PËR DREJTËSINË, MANJA: PAS TRAJNIMEVE, GJYQTARË E PROKURORË DO TË KENË AKSES NË EKSPERTIZË NDËRKOMBËTARE

"Një kapitull ri për drejtësinë", e cilësori Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, nisjen e Projektit të Binjakëzimit të Shkollës së Magjistraturës. Ky projekt, i realizuar në partneritet me Francën, Italinë dhe Hollandën, synon të sjellë standartet më të larta ndërkombëtare për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Ministri Manja theksoi rëndësinë e këtij projekti në forcimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke siguruar që pas trajnimeve, gjyqtarët dhe prokurorët do të kenë akses në ekspertizë ndërkombëtare. Ai theksoi se përgatitja e shkëlqyer dhe transparencia janë thelbësore për ndërtimin e një drejtësie të besueshme dhe efikase. "Ky është një hap i madh përparrë në përpjekjet tona përtë ndërtuar një sistem drejtësie që i shërben qytetarëve," tha Manja, duke shprehur angazhimin e qeverisë përtë avancuar reformën në sektorin e drejtësisë.



MINISTRI I DREJTËSISË TAKON ZNJ. ŽIVKOVIĆ: NDIHMËS JURIDIKE FALAS, MODEL SUKSESI PËR RAJONIN

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, priti në një takim znj. Ivana Živković, Ndihmës Sekretare e Përgjithshme e OKB-së dhe Drejtoreshë e Byrosë Rajonale për Evropën dhe CIS në UNDP. Takimi u përqendrua në suksesin e programit të Ndihmës Juridike Falas në Shqipëri, një nismë që ka sjellë rezultate të dukshme dhe tashmë po konsiderohet si model suksesi përvendet e rajonit. Gjatë bisedimeve, Ministri Manja theksoi rëndësinë e mbështetjes nga UNDP dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), që ka mundësuar rritjen e aksesit në drejtësi përgjithshme përgjithshme publike përmes inovacionit dhe digitalizimit, duke modernizuar sistemin e drejtësisë dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve që i ofrohen qytetarëve. Ky program është një shembull konkret i avancimit të shërbimeve publike përmes inovacionit dhe digitalizimit, duke modernizuar sistemin e drejtësisë dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve që i ofrohen qytetarëve. Kjo nismë është një hap i rëndësishëm për reformimin e drejtësisë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, duke synuar një sistem më të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës.